

“I lumtur për popullin vëlla të Turqisë dhe mikun e çmuar Presidentin Erdogan për daljen me sukses të plotë nga një natë tejet e vështirë. Kështu ka shkruar në rrjetet sociale mëngjesin e sotëm kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama referuar tentativës për grusht shteti në Turqi.

Ndërkohë, reagime ka pasur edhe nga Partia Demokratike.

Në një deklaratë të shpërndarë me email, PD shkruan se ajo mbështet institucionet e zgjedhura demokratike.

“Partia Demokratike e Shqipërisë ka ndjekur me shqetësim zhvillimet e orëve të fundit në Turqi. PD shpreh mbështetjen për autoritetet e zgjedhura demokratike në Turqi, demokracinë dhe shtetin ligjor. Ruajtja e rendit kushtetues dhe rikthimi i paqes dhe sigurisë publike janë në interes të të gjithë qytetarëve të Turqisë dhe miqve e partnerëve të saj”, thuhet në deklaratën e PD.